

UDHËZIM
Nr. 28 datë 3.8.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 10.6.2021, “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT E TË EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË
VEND TË LIRË PUNE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT ‘MËSUES
PËR SHQIPËRINË’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 8 e kreut 8 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“8. Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga komisioni për vlerësimin psikosocial të punonjësve arsimorë dhe punonjësve të tjerë në institucionet arsimore parauniversitare.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi